



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Botim, Qershor 2021

# Bankat për Shoqërinë

RAPORT  
**CSR** 2020





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



## BANKAT PËR SHOQËRINË



# PARATHËNIE

## I nderuar Lexues!

Ti, që ashtu si ne të gjithë, vjen në këtë lexim pas një prove aspak të zakonshme dhe që rrallë ndodh në jetën njerëzore: mes një beteje me një virus të padukshëm dhe vdekjeprurës! Luftë për të shpëtuar jetë, jetën tonë, të të afërmeve tanë, të miqve, fqinjëve, shokëve, kolegëve, të komunitetit... Dhe kjo luftë për fitore zhvillohet me mjete të thjeshta – distancim social dhe përdorim i maskave – dhe me mjete të sofistikuara – vaksinë sot dhe më tej në pritje ndoshta të ilaçeve përkatëse.

Ne të gjithë treguam se e duam jetën tonë, u bëmë bashkë për të përballuar rrezikun e padukshëm, ashtu siç jemi bërë bashkë në përballimin e rreziqeve të tjera të dukshme në mbrojtjen e ambientit, klimës, vlerave natyrore, ekosistemit tonë të bashkekzistencës. Na takon ne të gjithëve, gjithë bashkëjetuesve të brezave dhe gjeneratave të ndryshme sot që, në emër të gjeneratës së re, të trashëgojmë mundësi jetese të pacenuara, të mos merakosemi vetëm për anën tregtare të veprimtarisë sonë, por kjo veprimtari të jetë e gjelbër, të mbrojë vlerat tona për sot dhe për nesër.

Në këtë situatë aspak të lehtë dhe të ndërlikuar, ne ishim në gjendje të tregonim vlera të larta humane përgjatë vitit 2020. Viti 2020 na vuri në sprovë. Ne treguam se përballojmë sfidat. Duke mos ndërprerë për asnjë moment atë që është e rëndësishme për t'iu ofruar njerëzve, për të qenë pranë tyre. Jo vetëm që veprimtaria bankare nuk u ndërpre, jo vetëm që ajo gjeti dhe zhvilloi më tej rrugë për të qenë pranë klientëve, por ajo nuk reshti së qeni pranë edhe ndaj njerëzve.

Në këtë botim të "Përgjegjësia Sociale të Korporatave 2020" do të gjeni se ku bankat kontribuuan me mbi 77 miliardë lekë hua, në cilët sektorë, në cilat objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm, sa aktivitete kanë zhvilluar, sa pranë janë ndodhur ko-



muniteteve, se ku kanë kontribuar me mbi 280 milionë lekë në projekte të komuniteteve... Një vit i tërë, plotë përpjekje dhe sakrifica, i fiksuar në këto faqe të këtij botimi vjetor të AAB-së. Krenar për çfarë bëjmë, për çfarë kontribuojmë dhe për çfarë synojmë. Mbi 6,500 punonjës, ku 73 për qind i takojnë gjinisë femërore, të cilat janë në mbi 72 për qind të pozicioneve drejtuese të industrisë bankare, bëjnë të mundur të ndjehen të dobishëm në jetën e përditshme ekonomike dhe sociale të shoqërisë sonë.

Pas një viti special, një botim special. Shfletojë, lexojë, përfshihu! Duam në qendër të jesh Ti!

Me konsideratë,  
**Bledar SHELLA**

A handwritten signature in black ink, appearing to read "B. Shella". The signature is fluid and cursive, written over a light grey rectangular background.

Kryetar  
Shoqata Shqiptare e Bankave

## Përmbajtja

<b>OBJEKTIVI 1</b>	Pa Varfëri .....	6
<b>OBJEKTIVI 2</b>	Zero Uri .....	8
<b>OBJEKTIVI 3</b>	Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie .....	11
<b>OBJEKTIVI 4</b>	Arsim Cilësor .....	16
<b>OBJEKTIVI 5</b>	Barazi Gjinore .....	19
<b>OBJEKTIVI 7</b>	Energji e Përballueshme .....	22
<b>OBJEKTIVI 8</b>	Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike .....	23
<b>OBJEKTIVI 9</b>	Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë .....	27
<b>OBJEKTIVI 10</b>	Zvogëlim i Pabarazive .....	29
<b>OBJEKTIVI 11</b>	Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme .....	31
<b>OBJEKTIVI 12</b>	Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm .....	34
<b>OBJEKTIVI 13</b>	Veprim për Klimën .....	36
<b>OBJEKTIVI 14</b>	Jeta nën ujë .....	38
<b>OBJEKTIVI 15</b>	Jeta në Stere .....	39
<b>OBJEKTIVI 16</b>	Paqe dhe Drejtësi Institucione të forta .....	40
<b>OBJEKTIVI 17</b>	Partneritet për Objektivat .....	41
<b>ART, SPORT &amp; KULTURË</b>	.....	42

# OBJEKTIVAT PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



## GOAL #1 Pa Varfëri

Mbi **356 000** llogari të reja bankare të bizneseve dhe individëve të hapura në banka gjatë vitit 2020.

Rreth **7.5** milion lekë të investuara në produkte të reja me qëllim përmirësimin e përfshirjes financiare.

Rreth **7** million lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Ofron inovacione për zhvillimin e produkteve të reja bankare, metodologjitë për vlerësimin e kredive, modelet e operimit dhe kanalet e shpërndarjes (duke përfshirë mobile banking) për përmirësimin e përfshirjes financiare, duke përfshirë edhe bankingun për njerëz të rritur që aktualisht nuk disponojnë llogari bankare, si dhe sigurimin në nivel mikro për rritjen e mbrojtjes sociale.

Siguron për të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht të varfrit dhe personat e cenueshëm, që të kenë të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe qasje në shërbimet bazë, të gëzojnë pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe formave të tjera të pronës, trashëgiminë, burimet natyrore, teknologjitë e reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, duke përfshirë edhe mikro-financën.



## DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

**FIBank Albania** ofroi aplikacionin e ri FIBank Mobile, i cili është një shërbim i ofruar nga banka për të gjithë klientët e saj dhe u lejon atyre të kryejnë transaksione financiare në distancë, duke përdorur një pajisje të lëvizshme si telefon inteligjent ose tablet.

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Publikoi së brendshmi për të gjithë punonjësit e bankës “Rregullat mbi diversitetin për orientimin seksual dhe identitetin”.
- Bordi i Drejtorëve miratoi Parimet e Diversitetit dhe Përfshirjes.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**Banka OTP Albania**, pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019, u angazhua për t’iu ardhur në ndihmë personave në zonat e prekura nga kjo tragjedi. Thirrjes për të mbledhur ndihma iu përgjigjën punonjësit e bankës dhe shumë prej klientëve të saj. Banka, pasi bëri një vlerësim të situatës dhe mundësive, vendosi t’u vijë në ndihmë familjeve në Manzë duke prodhuar shtatë fjetoreve, ku u akomoduan gjithsej 30 persona. Kësaj nisme iu bashkuan edhe aktorë të njohur, të cilët mbështetën procesin e prodhimit të fjetoreve.

### Tirana Bank

- Ofroi mbështetjen e saj në mobilimin e një apartamenti në Golem, Kavajë.
- Mbështeti rikonstruksionin e banesës së një familje në nevojë në Sarandë.

## OBJEKTIVI #2 Zero Uri

Financim i agro bizneseve: **793** hua të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **3.2** miliardë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020: **5.2** miliardë lekë.

Bankat kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qeverinë dhe institucione financiare për rritjen e financimit për një bujqësi të qëndrueshme në shumën mbi **5** miliardë lekë.

Rreth **6.5** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet financiare për rritjen e financimeve për një bujqësi të qëndrueshme.

Bashkëpunim me shoqëri të tjera, Qeverinë dhe shoqërinë civile për identifikimin e mundësive të reja të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të biznesit (p.sh., financimi i farës dhe risive në mikro-ushqyerje).

Sigurimi i qasjes për të gjithë njerëzit, në veçanti për të varfrit dhe njerëzit në situata të cenueshme, duke përfshirë edhe foshnjat, në ushqime të sigurta, ushqyese dhe të mjaftueshme gjatë gjithë vitit.





## DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

**Raiffeisen Bank** dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) nënshkruan marrëveshje për mbështetjen e sektorit Agri. Banka ka ofruar hua afatshkurtra dhe investime për financimin e këtij sektori.

**Banka OTP Albania** dhe **Union Bank** nënshkruan marrëveshje me RCGF (Rural Credit Guarantee Foundation) për financimin e kredive në sektorin e agrikulturës.

### Credins Bank

- Pjesëmarrëse në Panairin “Shijo produktet lokale të Tiranës”. Me bankën lëvizëse, u mirëpritën të gjithë klientët e këtij sektori për t’i informuar ata mbi mbështetjen dhe bashkëpunimin që banka ofron për kredinë agro deri në 3 milionë lekë, si dhe mbi shumë avantazhe të tjera.
- Në bashkëpunim me Innovation Investment Fund, mbështeti organizimin e “Agro-Turizmi: Sektori primar për investim”.

**Banka OTP Albania** në datat 23 - 25 tetor 2020, mori pjesë në panairin “Tirana Agro 100”, organizuar në sheshin Skënderbej nga Bashkia e Tiranës dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, në të njëjtën kohë duke e sponsorizuar këtë aktivitet. OTP Bank Albania zgjodhi panairin “Tirana Agro 100” për të qenë më pranë fermerëve dhe sipërmarrësve ruralë, duke ofruar për grupet e interesit konsulencë bankare, përfshirje në financë dhe ndërgjegjësimin e publikut për produktet dhe shërbimet e saj.

**ProCredit Bank** prezantoi një shërbim të ri përmes kanaleve online. Duke vizituar faqen e internetit, klientët mund të aplikojnë për disa shërbime bankare, përfshirë hapjen e llogarisë. Gjithashtu një përditësim i bankingut celular ndodhi gjatë vitit 2020, duke ofruar zgjidhje shumë fleksibël kushtuar Klientëve Privat, duke i bërë ata të përfitojnë nga avantazhe, të tilla si kursimi i kohës dhe parave.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**Alpha Bank Albania** mbështeti 100 familje të prekura financiarisht nga pandemia e COVID-19. Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, u shpërndanë 100 pako ushqimore dhe artikuj sanitarë.

### **Banka Amerikane e Investimeve**

- Gjatë muajve prill-korrik, në vijim të përpjekjeve për të zbutur situatën e krijuar nga Covid-19, u është gjendur pranë komuniteteve dhe grupeve në nevojë. Banka iu përgjigj kërkesave të Kryqit të Kuq Shqiptar, Bashkisë Kamzë, Bashkisë Selenicë, Njësive Administrative Kotë dhe Armen, si edhe Shoqatës për Integrimin e Pensionistëve të Shqipërisë, me dhurimin e mbi 700 paketave ushqimore për familjet shqiptare në nevojë dhe pensionistëve të vetmuar në kushte të varfërisë ekstreme në Tiranë, Vorë, Kamëz dhe Paskuqan.
- Dhuroi 3,2 tonë produkte ushqimore për familjet shqiptare në nevojë, shpërndarja e të cilave u bë në bashkëpunim me organizata të ndryshme, si Kryqi i Kuq Shqiptar, Down Syndrome Albania; organizata partnere të Food Bank Albania; Qendra Sociale e Bashkisë Tiranë, Caritas Shqipëri dhe Qendra OAZ.
- Në prag të festave të fundvitit, bashkëpunoi me Fondacionin “Jo Gjakmarrjes, Po Jetës” dhe dhuroi paketa ushqimore për dhjetëra familje në kushte të vështira ekonomike, si dhe veshje për fëmijët e këtyre familjeve.

### **Credins Bank**

- Mbështeti Kryqin e Kuq, Tiranë në dhurimin e disa pakove ushqimore për familjet në nevojë përgjatë periudhës së pandemisë.
- Mbështeti “SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiptarë” duke mbuluar shpenzimet për 2 fëmijë.
- Shpërndau ushqime për 150 familje në nevojë në bashkëpunim me organizata të ndryshme.

### **Banka OTP Albania**

- Kontribuoi në shpërndarjen e ndihmave ushqimore për fëmijët me aftësi të kufizuar. Në datën 3 korrik 2020, në mjediset e shkollës “Avni Rustemi”, u shpërndanë 100 pako me ushqime për 100 familje me fëmijë me aftësi ndryshe.
- Përgjatë muajit gusht, u shpërndanë ndihma ushqimore në mbështetje të disa familjeve në vështirësi ekonomike, ku njëri prej prindërve nuk jeton më dhe fëmijët janë minorenë me statusin e jetimit.
- Një ndihmë e vogël me dashuri të madhe! Mirësia ngroh çdo shtëpi! Banka kontribuoi në shpërndarjen e ndihmave ushqimore për disa familje në nevojë, në të gjithë qytetet ku është e pranishme me degë. Për të ndihmuar në mbështetjen e familjeve të prekura nga pandemia e Covid-19 dhe komuniteteve në nevojë, banka dhuroi pako me ushqime me rastin e festave të fundvitit.

### **Raiffeisen Bank**

- Në mbështetje të të moshuarve që jetojnë të vetmuar apo në vështirësi ekonomike, u shpërndanë 350 pako me ushqime, ku nuk mungoi edhe kontributi i dhënë nga stafi i bankës.
- Në fund të vitit, mbështeti iniciativën “Skuadra e elfëve të verdhë”, nëpërmjet së cilës 10 familje në nevojë në qytetet Elbasan, Shkodër, Krujë dhe Lushnjë u ndihmuar me ushqime dhe veshmbathje.

### **Tirana Bank**

- Mbështeti Bashkinë Kamzë, ku shpërndau ushqime për njerëzit në nevojë të prekur nga situata e krijuar nga pandemia e Covid – 19.
- Bashkëpunoi me Kryqin e Kuq dhe mundësoi blerjen e çantave dhe artikujve shkollorë për fëmijët e familjeve në vështirësi financiare.

## OBJEKTIVI #3 Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie

Investim për institucione shëndetësore: **43** hua të reja të dhëna gjatë vitit 2020, në vlerën në vlerën mbi **800** milionë lekë.

Shuma e papaguar në fund të vitit 2020: **2.75** miliardë lekë.

Rreth **8.7** milionë lekë në mbështetje të punonjësve të bankave të prekur nga tërmeti dhe pandemia.

Mbi **40** milionë lekë mbështetje ndaj punonjësve dhe familjeve të tyre në sigurimin privat të shëndetit.

Rreth **47.2** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Sigurimi dhe/ose mbledhja e fondeve për investime për institucionet shëndetësore.

Shqyrtimi i hartimit të politikave që përfshijnë shërbime të transfertave të parasë nëpërmjet telefonit celular për transferimin efektiv të fondeve me qëllim mbulimin e kostove shtesë që lidhen me kujdesin shëndetësor shtetëror.

Vendosja e një bashkëpunimi me ofruesit e telefonisë celulare dhe organizatat komunitare për mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë shëndetin, duke reduktuar numrin e kredive të papaguara dhe kërkesat për sigurim që lindin nga çështjet shëndetësore.

Mbështetje ndaj punonjësve, familjeve, komuniteteve dhe kombeve të shëndetshme, duke siguruar ambiente të shëndetshme dhe të sigurta pune.



## PANDEMIA COVID – 19

### **Bankat në mbështetje të punonjësve, familjeve dhe klientëve, duke siguruar ambiente të shëndetshme dhe të sigurta pune.**

Në përgjigje të situatës së krijuar, të gjitha bankat morën masa të menjëhershme për të siguruar vazhdimësinë e plotë të shërbimeve bankare, dhe për të mbrojtur shëndetin e klientëve dhe punonjësve të tyre. Në vijim të protokollit të masave të miratuara nga organet kompetente, bankat ndërmorën disa masa, si p.sh.: përgatitja e protokollit të veprimit për rastet e dyshuara me Covid-19; punë nga shtëpia për një përqindje të lartë të punonjësve; plotësimi i çdo hyrje të mjediseve me termometër digjital; dezinfektim periodik i të gjitha ambienteve të punës; pajisjen e të gjithë punonjësve me doreza dhe maska; vendosjen e mbrojtëseve të plastikës në sportelet e degëve të bankave, vendosjen e posterave informues në ambientet e bankës; komunikim javor mbi situatën me punonjësit, etj.

Për të shmangur vizitat e panevojshme në degë, në kuadër të masave parandaluese, bankat vunë në dispozicion për klientët e tyre platformat digjitale, me anë të së cilave mund të kryhen nga shtëpia transaksione bankare, transferata apo pagesa të domosdoshme, duke hequr dhe komisionet për veprimet online. Në të njëjtën kohë, edhe përdorimet e kartave të debitit dhe të kreditit, duke ofruar mundësinë e blerjes pa kontakt dhe kufizimin e përdorimit të monedhave dhe kartëmonedhave.

Në vijim të zbatimit të masave të ndërmara nga Qeveria për situatën e krijuar, Shoqata Shqiptare e Bankave, në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), bashkëpunoi për shpërndarjen e pensioneve për ata pensionistë që nuk mund të tërheqin dot pensionet në bankë.

Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Credins Bank, FIBank Albania, Banka OTP Albania, Union Bank mundësuan dërgesën në shtëpi të pensioneve të pensionistëve, të cilët nuk mund shkonin dot në bankë.

### **Në mbështetje të punonjësve dhe familjeve të tyre në sigurimin privat të shëndetit**

Bankat bashkëpunojnë me shoqëri të njohura të sigurimit privat dhe ofrojnë për punonjësit e tyre sigurimin e shëndetit dhe paketat vjetore të përfitimeve. Paketa ose karta të ndryshme sigurimi shëndeti me kushte preferenciale iu vunë në dispozicion edhe familjarëve të stafit, për zgjedhje sipas interesit.

Për më tepër, gjatë vitit 2020, punonjësit e disa bankave kanë përfituar edhe kryerjen e testeve të Covid si dhe pagesë të plotë për periudhë karantinimi, në rast të ndonjë anëtari të stafit të prekur nga Covid.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

### Banka Amerikane e Investimeve

- Dhuroi në 24 prill tre pajisje respiratore për terapi intensive, të cilat i shkojnë në ndihmë sistemit shëndetësor për të rritur kapacitetet e tij në përballje me situatën e krijuar nga COVID-19.
- Mbështeti Spitalin Rajonal të qytetit të Durrësit dhe Qendrën Shëndetësore Nr.4 me materiale dhe veshje mbrojtëse për personelin shëndetësor.
- Dhuroi për QSUT një pajisje elektro-kirurgjikale për Shërbimin e Kirurgjisë Vaskulare.
- Mbështeti qendrën “TISS” në Tiranë – Qendrën e Shërbimeve dhe Trajtimit Psiko-Social për fëmijë të moshës 1-12 vjeç. Projekti synoi fuqizimin e shërbimeve terapeutike, nëpërmjet pajisjeve me materiale didaktike dhe elektronike, të konsideruar si mekanizma të rëndësishëm për rezultate pozitive në zhvillimin psikologjik të fëmijëve.
- Mbështeti për të katërtin vit radhazi fushatën e YWCA Albania nën moton “Fjongoja rozë më kujton”, për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës së përgjithshme për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Risi e fushatës për këtë vit ishte puna lobuese për hapjen e Qendrës për Mbështetje Psiko-Sociale për gratë e diagnostikuara dhe familjet e tyre. Në datën 23 tetor, ABI Bank si sponsor Platin, iu bashkua marshimit simbolik të organizuar në qytetin e Elbasanit.

### Banka Kombëtare Tregtare

- Mbështeti Spitalin e Elbasanit “Xhafer Kongoli” duke dhuruar auto-refraktometër për shërbimin okulist në Qendrën Spitalore, në mënyrë që të përmirësojë infrastrukturën mjekësore dhe shërbimin.
- Në kuadër të fushatës sensibilizuese për parandalimin e përhapjes së COVID-19, mbështeti Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri - Turqi (ATTSO).

### Credins Bank

- Mbështeti spitalin Rajonal Shkodër, duke blerë pajisje spitalore për ambientet e spitalit dhe përmirësuar ofrimin e shërbimit.
- Mbështeti spitalin “Shefqet Ndroqi”, duke dhuruar 2 pajisje spitalore “Echo Portable”.
- Në prag të nisjes së vitit të ri shkollor 2020-2021, dhuroi maska dhe dezinfektues për disa shkolla të Tiranës, duke besuar në vlerat e arsimit dhe kulturës si një kontribut i çmuar në dobi të komunitetit.
- Mbështeti Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë, duke mbuluar shpenzimet për blerjen e dezinfektuesve, maskave dhe dorezave për punonjësit e këtij institucioni.
- Për të përmirësuar infrastrukturën dhe siguruar ambiente të shëndetshme pune në institucion për një shërbim sa më të mirë ndaj komunitetit, Credins Bank mbështeti: Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Elbasan, I.E.V.P Durrës, A.SH.K Drejtoria Vendore Fier; Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, Qendrën Spitalore të Burgjeve, Spitalin Rajonal Berat.



### **FIBank Albania**

- Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, kur çdo vit banka luan një rol të rëndësishëm për të rritur ndërgjegjësimin dhe mbështetur luftën kundër kancerit në Shqipëri.
- Iu bashkua fushatës humanitare të Down Syndrome Albania për të lehtësuar efektet e pandemisë, dhe ndihmoi me paketa ushqimore 60 familje në nevojë, në rajonin e Matit që mbulojnë fshatrat German, Suat, Koms, Burgajet, Derjan, Shulbater dhe brenda qytetit të Burrelit.
- Banka i personalizoi kartolinat e urimit për festat e fundvitit në mbështetje të Fondacionit “Spitali Nëna dhe Fëmija” dhe kauzën e tij për të ndihmuar të porsalindurit dhe familjet e reja në nevojë.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** përmes një videoje dedikuar rëndësisë që ka diagnostikimi i hershëm dhe kontrolli rutinë për identifikimin dhe trajtimin në kohë të kancerit të gjirit, u angazhua për të përcjellë mesazhe sensibilizuese në muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Mesazhi u shpërnda në të gjitha kanalet zyrtare të bankës dhe tek i gjithë stafi, nëpërmjet email-it.

### **Raiffeisen Bank**

- Për të bërë të mundur përmirësimin e kushteve spitalore, mbështeti mbi 15 projekte të ndryshme, veçanërisht disa spitale dhe qendra shëndetësore në të gjithë vendin. Ndër projektet më të rëndësishme përmenden: rikonstruksioni i pavijonit të pediatri në Spitalin Rajonal Sarandë, sistemi i ngrohjes në pavijonin e pediatri në Spitalin Rajonal Fier, rikonstruksioni i pavijonit të urgjencës në spitalin Rajonal Lushnje, pajisjet e nevojshme të urgjencës në spitalin Rajonal Korçë, si dhe shumë projekte të tjera në spitale Durrës, Kukës, Skrapar, Kuçovë, etj.
- Iu bashkua përpjekjeve të institucioneve shëndetësore për të përballuar situatën e shkaktuar nga Covid-19 në Shqipëri, duke dhuruar një fond të konsiderueshëm në ndihmë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Në muajin tetor, në mbështetje të rritjes së ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, iu bashkua kësaj kauze, duke dhuruar për klientet femra 300 kuponë për ekzaminim mamografie falas.
- Më datë 20 nëntor, në Ditën Botërore të Fëmijëve, falë mbështetjes së Raiffeisen dhe fondacionit “Ti je një lule dielli”, nëpërmjet terapisë së artit u ndihmuan fëmijët e hospitalizuar në repartin e Pediatri në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
- Për t’i ardhur në ndihmë sistemit arsimor, bëri të mundur pajisjen e disa shkollave dhe çerdheve në



qytetin e Beratit dhe Kuçovës me 70 termometra me rreze infra të kuqe, duke u kujdesur për sigurinë dhe shëndetin e fëmijëve që frekuentojnë këto institucione.

### **Banka OTP Albania**

- Në muajin tetor 2020, Banka OTP Albania iu bashkua Festivalit Zumba Master Club, i cili u organizua në 3 tetor 2020 në mjediset e Liqenit Artificial të Tiranës.
- Në korrik të vitit 2020, banka sponsorizoi blerjen e një pajisje mjekësore “Matës parametrash” për Spitalin Rajonal Devoll.

### **Tirana Bank**

- Në kuadër të mbështetjes për mjekësinë, u bë e mundur që Qendra Shëndetësore Piskovë, Përmet të bëhet funksionale dhe të funksionojë normalisht për pacientët e zonës.
- Dha kontributin e saj pranë Spitalit Rajonal të qytetit të Shkodrës, duke sponsorizuar blerjen e filmave të grafive.
- Përgjatë muajit tetor, zhvilloi një aktivitet nën moton: “Ne Jemi Me Ty, Për Të Triumfuar!”. Simboli i kësaj fushate ishte dhurimi i një fjongoje rozë çdo zonje të stafit të Tirana Bank. U ndërtua një stendë, e cila shërbeu për foto dhe qëndroi në mjediset e zyrave qendrore gjatë gjithë muajit, duke bërë të mundur realizimin e fotove të ndryshme me stafin. U realizuan element dekorativ në hyrjen kryesore të Tirana Bank, dhe u realizua dita e premte si “Pink Day” (datë 16, 23 & 30 tetor), duke përfshirë në veshjet e punonjësve femra element me ngjyrën rozë.

### **Union Bank**

- Në mbështetje të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, gjatë muajve gusht-tetor 2020 ndihmoi në mënyrë të vazhdueshme për furnizimin e QSUT me bateri për aparatet oksimetra që përdoren për trajtimin e pacientëve me Covid. Ky projekt u lidh edhe me klientët e Union Bank, të cilët dhanë ndihmën e tyre për rritjen e numrit të baterive të dhuruara, ku për çdo 4 transaksione të kryera në platformën e-banking UB Online, u dhurua një bateri.
- Edhe për vitin 2020 zgjodhi të uronte klientët dhe bashkëpunëtorët me kartolina të përgatitura nga fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me sfida në zhvillim, të ofruara nga Fondacioni “Down Syndrome Albania”. Me blerjen e këtyre kartolinave, u mundësua ofrimi i shërbimeve terapeutike pa pagesë për fëmijët në nevojë në qendrën e shërbimeve “Pro Pak”.

### **Dhurim vullnetar gjaku**

Alpha Bank Albania, Banka Amerikane e Investimeve, FIBank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Raiffeisen Bank.

Kjo nismë synon të motivojë individët që të dhurojnë gjak rregullisht në mënyrë vullnetare nëpërmjet bankave të mirëorganizuar për dhurimin e gjakut (Kryq i Kuq). Stafit i bankave me shumë përgjegjshmëri, nisur nga nevoja dhe misioni human, mbështeti këtë kauzë jetike duke zbatuar protokollin e përcaktuar në situatë pandemie.

## OBJEKTIVI #4 Arsim Cilësor

Financim i shpenzimeve të arsimit: **356** hua të reja të dhëna në vlerën mbi **250** milionë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020: **416** milionë lekë.

Rreth **24** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

Nëpërmjet AAB-së janë financuar rreth **1 982 878** lekë nga bankat për trajnimin e 265 punonjësve të tyre (trajnimet janë zhvilluar online për shkak të pandemisë).

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Bashkëpunim me institucionet financiare dhe qeveritë për të rritur dhe/ose investuar në financimin novator për projektet e arsimit.

Zgjerimi i qasjes dhe shfrytëzimi i kursimeve personale dhe produkteve të kredisë për t'u ardhur në ndihmë familjeve në lidhje me planifikimin dhe financimin e shpenzimeve të arsimit.

Ofrimi i këshillimit për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë e marginalizuar për përmirësimin e rezultat-ëve në mësim dhe qasja e industrisë në rrjetin e talenteve të larmishme, çka ofron modele thelbësore për përmirësimin e përfshirjes sociale.

Rritja e ndjeshme e numrit të të rinjve dhe të rriturve me aftësi të caktuara, duke përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale për punësim, punë të denjë dhe sipërmarrje.





## DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

**Banka Amerikane e Investimeve** nënshkroi në 27 shkurt një marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës për ofrimin e mundësive për programe të praktikave mësimore për studentët e këtij fakulteti.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania**, në marrëveshje me Ambasadën Italiane dhe Ambasadën Gjermane, certifikoi dhe garantoi aftësinë financiare të studentëve ndaj fondeve të depozituara si dhe siguroi transferimin e fondeve nga studentët, sipas kushteve të paracaktuara nga ambasadat dhe banka. Për më tepër, banka ofron paketa studentore, duke treguar kujdes të veçantë për këtë kategori. Për studentët miratohen terma preferenciale.

Ambasada Italiane gjatë vitit 2020: 102 llogari të reja.

Ambasada Gjermane gjatë vitit 2020: 133 llogari të reja.

Në 2020, banka ka nënshkruar marrëveshje me Universitetin Ecampus dhe Universitetin Epitech në ofrimin e normave preferenciale të interesit për të gjithë studentët e tyre.

## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

### Credins Bank

- Dhuroi pajisje kompjuterike për laboratorin e Informatikës së shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”.
- Sponsor i përgjithshëm i “Albanian Science and Engineering Fair (ASEF)” organizuar në Kolegjin Turgut Ozal në kategoritë: shkencë natyrore, linguistikë, dizajn faqe interneti, filma të shkurtër, robotikë, etj. Në këtë panair të shkencës, u prezantuan projekte novatore nga 1700 nxënës.
- Mbështeti Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale TIK “Hermann Gmeiner”, me rastin e Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale, organizuan konkursin me temë “Të rinjtë dhe privatësia” me punime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) me nxënës të kësaj shkolle. Banka Credins shpërbleu me 10 çmime nxënësit fitues.
- Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, Banka Credins, së bashku me gjithë stafin e saj, mbështeti fëmijët e Fshatit SOS me mjete didaktike dhe shkollore.
- Mundësoi blerjen e lodrave për fëmijët në Kopshtin 31.
- Mbështeti Konferencën Kombëtare të Shkencave Mjekësore 7.

### Banka Kombëtare Tregtare

- Zgjodhi të jetë pranë studentëve të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, duke bërë të mundur dhurimin e librave për bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Humane.
- Mbështeti Qendrën e Botimeve për Diasporën për publikimin e Fjalorit Shqip-Ukrainisht, i cili është botuar dhe shpërndarë për fëmijët e diasporës shqiptare deri në 6 vjeç në Ukrainë, me qëllim promovimin e gjuhës shqipe për fëmijët e diasporës, si dhe 14 përralla klasike të përshtatura në të dy gjuhët për grup moshat 5-8 vjeç. Këto përralla janë botuar në 7 libra të ndryshëm.
- Dhuroi pajisje për të përmirësuar infrastrukturën e IT-së, duke nxitur inovacionin teknologjik në institucionet: Drejtoria Rajonale Arsimore Rrogozhinë, Bashkia Liqenas dhe I EVP Peqin.
- Mbështeti Bashkinë Delvinë, e cila, me rastin e festave të fundvitit, shpërndau dhurata për fëmijët e shkollave, kopshteve dhe çerdheve të qytetit.

**Raiffeisen Bank**

- Gjatë vitit 2020, u vunë në jetë një sërë projektesh në disa shkolla në vend, për një rifillim sa më të mbarë të vitit të ri akademik. U mundësua:
- Pajisja e shkollës 9-vjeçare “Vrinë” në Sarandë me një terren të ri sportiv.
- Pajisja e shkollës “Petro Nini Luarasi” në Ersekë dhe e shkollës “Konferenca e Pezës” në kryeqytet me laboratorë të rinj informatike.
- Pajisja e shkollës “31 Korriku” Mat me një bibliotekë të re.
- Pajisja e shkollës “Bardhyl Pojani” në Korçë me pajisje të reja kompjuterike dhe pajisja e shkollës “Kryezi” me një sallë të re mbledhjesh.
- Ofroi mbështetje për disa institucione, duke pajisur me pajisje kompjuterike dhe pajisje të ndryshme zyrat arsimore Shkodër, Roskovec, Tiranë dhe Tepelenë–Memaliaj.
- Një tjetër projekt i rëndësishëm ishte mobilimi i 3 kopshteve dhe 2 çerdheve në qytetin e Burrelit. Falë këtij projekti, rreth 500 fëmijë nga mosha 0-6 vjeç që frekuentojnë këto institucione kanë tashmë shtretër të rinj, por edhe hapësira argëtimi tejet komode.
- Mundësoi pajisjen me tituj të rinj librash dhe pajisje kompjuterike të bibliotekës në qytetin e Lezhës.
- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt, Raiffeisen Bank, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), prezantuan projektin: “Orientimi dhe edukimi i fëmijëve në përdorimin e internetit”. Më anë të këtij projekti u mundësua ndërtimi i këndit të sigurisë kibernetike #CyberCorner për vizitorët e bibliotekës “Hamit Beqja” në kryeqytet. CyberCorner do të jetë këndi ku fëmijët dhe të rinjtë do të pajisen me njohuri të thelluara për përdorimin e internetit të sigurt, kodimin, luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe shërbimet elektronike publike. Për secilën nga këto tema janë hartuar module, si dhe janë instaluar pajisje kompjuterike dhe një sitekiosk, me të cilat mund të ndërveprohet gjatë qëndrimit në mjediset e bibliotekës. Projekti synon rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë e fëmijëve në internet dhe aftësimin e tyre për përdorimin e e-shërbimeve (shërbimeve elektronike).
- Mbështeti Bashkinë e Tiranës për krijimin e një laboratorit teknologjik në qendrën multifunktionale TEN, ku të rinjtë do të kenë mundësi të ndjekin kurse falas në fushën e multimedias dhe dizajn-montazhit.
- Mbështeti projektin studentor të qendrës “Abc Tirana Club” me temë “Edukimi ekonomik dhe financiar i publikut”.
- Mbështeti shtëpinë e fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë, duke bërë të mundur që çdo fëmijë nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të në këtë institucion të mos i mungojë çanta e re e shkollës dhe asnjë material tjetër i domosdoshëm për procesin mësimor. Gjithashtu, Raiffeisen dhuroi edhe 8 laptopë, të cilët do t’i vijnë në ndihmë fëmijëve për procesin mësimor online.

**Banka OTP Albania**

- Organizoi Konkursin “Research Paper” me pjesëmarrjen e studentëve të disa universiteteve. Duke iu përmbajtur temës “Impakti i COVID-19 në Shqipëri – Si do të operojnë bankat tani?”, studentë nga fusha të ndryshme ofruan idetë e tyre për zgjidhje novatore në shërbimet bankare. Konkursi u kurorëzua me tre grupe fituese dhe studentët patën mundësinë të bëhen pjesë e programit të praktikave mësimore në bankë dhe njëkohësisht mundësinë për t’u bërë pjesë e stafit të saj në vijim.
- Pandemia shkaktoi një sërë kufizimesh. Një prej tyre ishte edhe organizimi i panairit të librit në formatin tradicional të tij. Banka OTP Albania vendosi të mbështesë Panairin Online të Librit, i cili u organizua në datat 12–30 nëntor 2020, duke sponsorizuar prodhimin e videove promovionale për këtë aktivitet.
- Hackathonen “Mobile UX”: Një veprimtari me studentë të talentuar dhe mundësi për çdo pjesëmarrës për të qenë jo vetëm fitues i çmimeve, por edhe i një karriere në sistemin bankar.
- Në ndihmë të gjithë fëmijëve të pasionuar pas shkencës së matematikës, banka vendosi të sponsorizojë botimin e librit me ushtrime matematike, i cili u përgatit në kuadër të organizimit të Konkursit Ndërkombëtar të Matematikës “Kangur 2021”.

**Union Bank** në fund të vitit mbështeti projektin “Babagyshi sekret” të shoqatës “Ura” duke dhuruar librin “Udhëtimi i Babagyshit në qytetin e 1001 dritareve”. Ky libër u dhurua edhe për fëmijë të stafit dhe të klientëve, me qëllim stimulimin e leximit, duke e vlerësuar librin si mikun më të mirë që duhet t’i shoqërojë gjatë rritjes.

## OBJEKTIVI #5 Barazi Gjinore

Kredi për SME që drejtohen nga gratë: **1,481** hua të reja të dhëna në vlerën mbi **22** miliardë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020: mbi **35** miliardë lekë.


Në fund të vitit 2020, bankat raportojnë **6,557** punonjës, **4,754** prej të cilëve ishin femra. Punonjës gjithsej në nivel drejtues **927** nga të cilët **671** femra në borde dhe role drejtuese.

Rreth **1.4** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Përshtatja e proceseve të kredisë dhe metodave të huadhënies për të zgjeruar dhënien e kredive për NVM-të e drejtuar nga gratë, për shembull, duke ofruar kredi pa kolateral.

Rritja e përqindjes së grave në bordet e shoqërive dhe rolet drejtuese, dhe investimi në politika dhe programe në mbështetje të grave si fuqi punëtore, si dhe nxitja e organizatave në zinxhirin e vlerave për ndërmarrjen e nismave të ngjashme.



## DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

Dita Ndërkombëtare e Gruas në **FIBank Albania** festohet ndryshe. Surprizat për punonjëset femra këtë vit ishin kuti me dhurata, me material të ricikluar, si një shenjë vlerësimi për punën e palodhur dhe përkushtimin e vazhdueshëm ndaj FIBank. Çdo vit, FIBank promovon punonjëset aktuale femra dhe u siguron trajnime të vazhdueshme.

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Mbështet Programin e Grave në Biznes në Ballkanin Perëndimor, i cili promovon pjesëmarrjen e grave në biznes, duke ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) të drejtura nga gratë. Financime afatshkurtra dhe afatmesme u ofruan për klientë të NVM-ve për të mbuluar nevojat e tyre për projekte investimi, si dhe për të mbuluar nevojat e tyre për shpenzimet operative të nevojshme në biznesin e përditshëm.
- Për nënat që ushqejnë me gji është parashikuar një leje me pagesë në afate të ndryshme kohore gjatë ditës pas kthimit të tyre në punë nga leja e lindjes. Banka ofron përfitime të zgjeruara (përtej kërkesave të legjislacionit vendor) të kujdesit shëndetësor për të gjithë punonjësit. Këto përfitime përfshijnë ndihmë mjekësore 24/7, kontroll të zgjatur dhe ekzaminime, si dhe rimbursim të shpenzimeve mjekësore deri në 1000 euro në vit, dhe janë në dispozicion në Shqipëri dhe Itali. Duke filluar nga 2018 dhe më tej, nënat beqare rimbursohen nga banka për kostot e librave të shkollës për fëmijët e tyre. Banka kontribuon në zhvillimin profesional të ekipit femëror, duke mbështetur tarifat e anëtarësisë financiare në një organizatë profesionale (si Shoqatat e Avokatëve, Instituti i Audituesëve të Brendshëm, etj.). Akses preferencial në Smart Work për gratë që kthehen nga leja e lindjes. Banka ka siguruar laptopë të dedikuara për këtë kategori të të punësuarve.
- U bashkua me fushatën e UN Women Albania për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore” është një fushatë ndërkombëtare që zhvillohet çdo vit edhe në Shqipëri, e cila nis më 25 nëntor - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, deri më 10 dhjetor - Dita e të Drejtave të Njeriut, duke treguar që dhuna ndaj grave është shkelja më e përhapur e të drejtave të njeriut në të gjithë botën. Në mbështetje të fushatës, logo e bankës u bë portokalli dhe u shpërndanë mesazhe të dedikuara në rrjete sociale. Për më tepër punonjëset të bankës iu kërkua të përditësojnë foton e profilit të tyre në Facebook me kornizën e UN Women “DEGJO, BESO, MBESHTET gratë dhe vajzat!”
- Nisma specifike për të gjeneruar sensibilizim në lidhje me Diversitetin Gjinor:  
Në të gjitha komitetet e bankës, përfaqësimi i grave është 48%. Gratë përfaqësojnë shumicën në tre prej komiteteve më të rëndësishme të menaxhimit të bankës, siç janë: EXCO, Komiteti i Kredive dhe Komiteti i Auditit të Brendshëm (përkatësisht: përfaqësuesit e grave EXCO: 57,1%; përfaqësuesit e grave të Komitetit të Auditit të Brendshëm: 60% dhe përfaqësimi i grave në Komitetin e Kredisë: 60%).  
  
Në të gjitha komitetet e jashtme (Shoqata Shqiptare e Bankave, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, Dhoma Amerikane e Tregtisë), përfaqësimi i grave në ISBA është 79%.
- Më 8 mars 2020, një kartolinë (kopje fizike) iu dorëzua të gjitha grave punonjëset të bankës me shënimin: Ky është një mendim për ty, grua e fortë e bukur! Gjithçka që mund të imagjiloni, mund të krijoni! -

Oprah Winfrey

Gëzuar Ditën e Gruas! Ne jemi krenarë që në Intesa Sanpaolo Bank Albania më shumë se 70% e forcës së saj të punës është e përbërë nga gratë, ndërsa përqindja e grave në ekipin e lartë drejtues është 75%! Faleminderit që jeni pjesë e Intesa Sanpaolo Bank Albania!

Kjo fushatë u promovua gjithashtu në rrjetet sociale të bankës.

- Kartolina simbolike u dërguan për çdo punonjës të bankës dhe gjithashtu në rrjetet sociale të saj në: Ditën Botërore për Diversitetin Kulturor, Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Mëmë dhe Ditën Botërore të Refugjatëve.

### **ProCredit Bank**

Pozicionet e BackOffice në departamentet e pagesave ose administrimit të kredive dominohen nga gratë në ProCredit. Në përputhje me politikën e bankës kundër diskriminimit të çdo lloji, gjinia nuk luan aspak rol në promovimin ose vendimet e pagave. Nuk ka asnjë ndryshim në pagë midis burrave dhe grave në pozicione të krahasueshme.

## **PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE**

### **Banka Amerikane e Investimeve**

- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, qendra “Vatra”, me mbështetjen e ABI Bank, ndërmori në qytetin e Vlorës aktivitetin publik sensibilizues për të përcjellë mesazhin “Ti japim fund dhunës dhe shfrytëzimit të grave dhe vajzave”, për të cilin u prodhuan dhe u shpërndanë materiale sensibilizuese me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe dhënien e mesazheve kundër dhunës dhe shfrytëzimit. Gjithashtu, u shpërndanë fletëpalosje me informacion dhe numra kontakti për të raportuar dhunën në familje dhe shfrytëzimin e grave dhe vajzave.
- Forumit të Gruas Elbasan iu ofrua mbështetje në shërbimin e saj primar, “Strehëzën e Emergjencës” për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje. Mbështetja është ofruar edhe për 5 raste të grave të dhunuara së bashku me fëmijët e tyre, me mbulimin e shpenzimeve të pagesës së qirasë së banesës dhe paketave ushqimore për 5 muaj, deri në periudhën e riintegrit të tyre.
- Mbështeti organizatën “Të ndryshëm & të barabartë”. Projekti synoi përmirësimin e mjediseve, duke bërë të mundur mobilimin e strehëzës për riintegrimin e viktimeve të trafikimit dhe qendrat e përkujdesjes ditore për fëmijët e tyre në Tiranë dhe Shkodër.

## OBJEKTIVI #7 Energji e përballueshme dhe e pastër

Hua për energjinë e rinovueshme: **148** hua të reja të dhëna në 2020, në vlerën mbi **10** miliardë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020: **37.7** miliardë lekë.

Rreth **250** mijë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

### DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

**Banka OTP Albania**, në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), mundësoi produktin më të ri: financim për investime eficiente në banesë për ekonominë e gjelbër. Në këtë mënyrë, Banka OTP Albania është pjesë e Programit WB GEFF, i projektuar dhe mbështetur me grante nga Bashkimi Evropian, në linjë të plotë me parimet e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave të Bankës dhe BERZH për jetesë të shëndetshme dhe investime të qëndrueshme dhe miqësore me natyrën. Produkti i njohur si kreditimi i ekonomisë së gjelbër GEFF (Green Economy Financing Facility) financon të gjithë investimet që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë së GEFF për investime të gjelbra në sektorin e banimit. Për t'i stimuluar këto investime, klientët e Bankës OTP Albania do të mund të përfitojnë grant në vlerë deri në 20%, të mundësuar nga BE.



## OBJEKTIVI #8 Punë dinjitoze dhe Rritje Ekonomike

Hua për SME me qëllim nxitjen dhe rritjen e qasjes në shërbimet bankare (pa-  
varësisht degës së ekonomisë): **2,057** hua të reja të dhëna në vlerën mbi  
**13** miliardë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020 mbi **35** miliardë lekë.

Hua për turizmin/agroturizmin: **558** hua të reja të dhëna në vlerën **8.3** mil-  
liardë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020 mbi **11.7** miliardë lekë.

Rreth **3.2** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve  
dhe komunitetit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Puna me aktorët kyç për gjetjen e zgjidhjeve praktike, të cilat do të ndryshojnë prirjen e bankave ndërkom-  
bëtare për tërheqjen e shërbimeve bankare përkatëse për shkak të kuadrit ligjor dhe rregulator.

Zgjerimi i mikrofinancave (kursime, kredi dhe sigurime) për pronarët e bizneseve të vogla.

Zgjerimi i financave për “shtresën me të ardhura të pamjaftueshme”, d.m.th. ndërmarrjet e vogla që lindin nga  
mikrofinanca, të cilat ende nuk janë në gjendje të marrin kredi nga sistemi bankar formal.

Sigurimi i praktikave të synuara për të rinjtë me prejardhje nga shtresat e pafavorizuara, me qëllim promovimin  
e lëvizshmërisë sociale, duke rritur gjithashtu performancën e shoqërisë përmes rritjes së shumëllojshmërisë  
së fuqisë punëtore.

Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve financiare vendase për nxitjen dhe zgjerimin e qasjes në shërbimet  
bankare, të sigurimeve dhe financiare për të gjithë.



## DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

### Bankat dhe pandemia

Në kuadër të gjendjes së rënduar për vendin, ekonominë shqiptare dhe në veçanti për sistemin bankar dhe institucionet e tjera financiare, si rrjedhojë e situatës së pandemisë COVID-19, Banka e Shqipërisë, ndër mori disa masa dhe ndryshime rregullatore për bankat, por jo vetëm, me qëllim kryesisht sigurimin e zgjidhjes së kërkesave të klientëve për periudha të përkohshme shtyrjeje dhe, njëkohësisht, sigurimin e shëndetit të bankave dhe sistemit në tërësi.

1. Pezullim të përkohshëm të zbatimit të detyrimit që rrjedh nga kërkesat për administrimin e rrezikut të kredisë, për klasifikimin dhe provigjionimin e kredive për të gjitha kategoritë e klientëve, për arsye të vështirësive financiare dhe rënies së aftësisë paguese të huamarrësve, ndikuar nga situata e krijuar;
2. Pezullim të përkohshëm të krijimit të fondeve rezervë për pasuritë e paluajtshme të përfuara kundrejt shlyerjes së kredive deri në muajin dhjetor 2020;
3. Dispozitë lehtësuese për kreditë e ristrukturuara, sipas së cilës bankave u jepet mundësi të ristrukturojnë marrëdhëniet aktuale të kredive me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme në varësi të aftësisë paguese të kredimarrësve deri më 31 dhjetor 2020, pa kosto shtesë të provigjioneve dhe pa përkeqësim të statusit të huamarrësve;
4. Shtyrje me 1 vit të hyrjes në fuqi të kërkesave më të shtrënguara për klasifikimin dhe provigjionimin e kredive të ristrukturuara, për në muajin janar 2022. Nëpërmjet kësaj mase bankat do të mund të përdorin edhe gjatë vitit 2021 të njëjtat kritere për klasifikimin dhe provigjionimin e kredive të ristrukturuara si ato përpara situatës së pandemisë;
5. Shtyrje me 1 vit të efekteve të rregullores “Për trajtimin jashtëgjyqësor nga bankat, të kredimarrësve në vështirësi financiare” deri në muajin janar 2022. Në këtë mënyrë, bankat do të kenë më shumë kohë të gjejnë një zgjidhje të përshtatshme për huamarrësit e përbashkët në vështirësi financiare.

Bankat kanë qenë plotësisht të angazhuara të ndërmarrin masa lehtësuese për klientët huamarrës, në zbatim të një vendimit të datës 12.03.2020 të Bankës së Shqipërisë për një ndryshim në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, dhe kanë aktivizuar masat lehtësuese për të plotësuar nevojat e klientëve të tyre në rast vështirësish/ pamundësie për të përmbushur detyrimet kontraktuale me bankën. Për të gjithë individët dhe shoqëritë, bankat kanë ardhur në ndihmë me mundësinë e ristrukturimit të kredisë, duke mos ngarkuar asnjë penalitet, apo përkeqësuar statusin e huamarrësit.

**Raiffeisen Bank** nënshkroi marrëveshje (risk sharing) me Fondin Evropian të Investimeve (EIF), me qëllim financimin e bizneseve të cilat punësojnë të rinj në biznes.

### ProCredit Bank

- Gjatë krizës COVID-19, banka u angazhua në një dialog intensiv për të gjetur zgjidhje strukturore me klientët. Për t'u përmendur është menaxhimi i kredive me probleme. Kreditë e fshira nga bilanci (Write-offs) mesatare të ProCredit Bank Albania në vitin 2020 ishin 5,9%, çka përfaqëson rreth 2% më pak se përqindja mesatare e sektorit bankar.
- Rekrutimi nuk u ndal kurrë gjatë pandemisë dhe veprimtaria vazhdoi online. Fokusi i përhershëm i bankës në digjitalizim rezultoi shumë efikas edhe gjatë pandemisë, ku stafi kaloi në punë në distancë.
- Ofron programin e punësimit “ProCredit Onboarding Program”, një program gjithëpërfshirës trajnimi për të sapo diplomuarit dhe individë me përvojë nga sektorë të ndryshëm. Një tjetër tipar kryesor dallues i Programit Onboarding është se ai nuk përgatit të sapoardhurit për një pozicion specifik, por i përgatit ata të gjithë që të kuptojnë dhe diskutojnë në tërësi filozofinë e biznesit të grupit.



- EIB dhe ProCredit Group hapën fondin 65 milionë euro për të shpejtuar rimëkëmbjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor nga kriza COVID-19. Kredia u është dhënë bankave ProCredit në Serbi, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Bosnjë & Hercegovinë për të mbështetur rimëkëmbjen dhe zhvillimin e sektorit privat në Ballkanin Perëndimor, pavarësisht nga pandemia. Shuma për Shqipërinë ishte 15 milionë euro, nga shuma totale prej 65 milionë euro. Ky transaksion siguron financime të nevojshme për shoqëritë që trajtojnë kapitalin e tyre të punës, likuiditetin dhe nevojat për investime përballë pandemisë së vazhdueshme. Paralelisht, operacioni forcon sektorin bankar rajonal dhe fuqizon aftësinë e tij për të financuar rimëkëmbjen ekonomike të Ballkanit Perëndimor.



## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**Alpha Bank Albania, Credins Bank dhe Tirana Bank** mbështetën Forumin Ekonomik të Tiranës. Në këtë forum morën pjesë aktorë të rëndësishëm vendas dhe të huaj, të cilët diskutuan rreth sfidave të zhvillimit ekonomik dhe konkurrencës në Shqipëri dhe rajon, dhe rreth praktikave më të mira të zbatuara në vende të tjera, të cilat mund të zbatohen në Shqipëri.

### Banka Kombëtare Tregtare

- Në mbështetje të institucioneve që ofrojnë shërbim për komunitetin, financoi Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Vlorë (ASHK) për të përmirësuar ambientet e tyre të punës.
- Mbështeti veprimtarinë e organizuar nga AKCESK (Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike) më 17-18 dhjetor 2020, me qëllim rritjen e vigjilencës në fushën kibernetike.

### Credins Bank

- Mbështeti Konkursin e Bizneseve të Gjelbra, në bashkëpunim me Partners Albania, i cili promovon inovacionin duke shfrytëzuar burimet lokale, duke nxitur zhvillimin e ekonomisë, rritjen e punësimit dhe ndërtimin e një rajoni sa më të gjelbër. Një nga fituesit e këtij konkursi u mbështet për zgjerimin e biznesit me produkte të reja.
- Uplift Albania: Një aktivitet dy mujor ku aplikuan mbi 50 startup-e nga 6 vende të rajonit dhe 9 industri të ndryshme. Credins Bank mundësoi dhënie të çmimit të madh për fituesin.

**FIBank Albania**

- Në janar. organizoi një udhëtim (retreat) të stafit, ku u ndërmorën shumë veprimtari të rëndësishme, për të forcuar marrëdhëniet shoqërore dhe për të përcaktuar rolet brenda ekipeve. Ky udhëtim përfshiu edhe trajnime të departamenteve të ndryshme. Veprimtaria u mbajt në një prej vendeve të pushimit në Durrës.
- FIBank nisi një lojë argëtuese në mediat sociale, ku inkurajoi pjesëmarrësit të sjellin foto gazmore nga mjediset e shtëpisë gjatë kësaj periudhe izolimi. Kjo lojë në mediat sociale u prezantua në kuadër të përcjelljes të mesazheve të qëndrimit në shtëpi.
- Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve ishte një mundësi që FIBank të nënvizojë kontributet e rëndësishme që njerëzit e moshuar i japin shoqërisë. Tema për vitin 2020 ishte “Pandemia: A ndryshon mënyra se si e trajtojmë moshën dhe plakjen?” FIBank uroi të gjithë klientët e saj të kësaj moshe dhe bashkëpunoi me Postën Shqiptare për të dërguar të gjitha pensionet direkt në shtëpitë e pensionistëve.

**OTP Bank Albania**

- Nisi një fushatë sensibilizuese për promovimin e turizmit vendas e quajtur “OTP rekomandon”, e cila promovon disa prej atraksioneve më të bukura në të gjithë Shqipërinë për t’u vizituar. Përgjatë saj, u komunikuan në rrjetet sociale lokacionet, hotelet dhe bujtinat nga i gjithë territori i Shqipërisë.
- “Jeto Shqip”, një fushatë promovuese dedikuar konsumit të produkteve shqiptare, e cila, nëpërmjet promovimit në rrjetet sociale të bankës, synon të inkurajojë forcimin e ekonomisë vendase nëpërmjet konsumit të produkteve dhe shërbimeve shqiptare.
- Banka sponsorizoi prodhimin e 64 tabelave drejtuese për 19 zona turistike në Bashkinë Gramsh, me qëllimin mundësimin e një rrugëtimi të lehtë dhe pa asnjë rrezik për të pasionuarit pas natyrës së egër dhe aventurës së hiking, trekking, etj.
- Gjatë disa muajve, banka prezantoi për herë të parë në rrjetet e saj sociale disa konkurse fotografie, të cilat kishin në fokus promovimin e turizmit vendas dhe evidentimin e vendndodhjeve më të bukura.
- Për bankën OTP Albania, klientët janë partnerët dhe bashkëpunëtorët më të vyer. Një fokus i veçantë në komunikimet publike i është dhënë edhe partnerëve; klientëve të rëndësishëm jo vetëm për bankën, por dhe për ndjekësit. Ata vijnë nga fusha e turizmit shqiptar, por jo vetëm, janë emra me të cilët vendi ynë prezantohet denjësisht në sytë e botës, me shërbime dhe produkte “Made in Albania”. Viti 2020 ishte një vit kur më tepër se kurrë duhej treguar mbështetje ndaj traditës dhe produkteve “Made in Albania”. Vetëm kështu mund t’i bëjmë ballë sfidave ekonomike që sjell pandemia.

**Tirana Bank**

Morri pjesë në aktivitetin e radhës HoReCa, i cili u organizua pranë Expo City në datat 4-6 mars 2020. HoReCa është ekspozita më e rëndësishme e specializuar në Shqipëri mbi temën e hotelerisë dhe turizmit. Pjesëmarrja e Tirana Bank, me përfaqësues dhe ekspertë të produkteve SME të lidhura me turizmin, mundësoi dhënie të informacionit të detajuar për rreth 4500 vizitorë të panairit.



## OBJEKTIVI #9 Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë

Hua për sektorin e transportit; infrastrukturës së komunikimit: **360** hua të reja të dhëna në vlerën **1.4** miliardë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020: **3.5** miliardë lekë

Mbështetje financiare për teknologjinë e informacionit (në institucione të ndryshme): **14** hua të reja të dhëna në vlerën mbi **80** milionë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020 mbi **250** milionë lekë.

Rreth **8** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.


### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Rritja e financimit afatgjatë për partneritetet publike-private në sektorin e transportit, energjisë së rinovueshme dhe infrastrukturës së komunikimit për të kontribuar në zhvillimin e tregtisë dhe qyteteve me aftësi ripërtëritëse.

Sigurimi i investimeve në infrastrukturë në sferën e influencës përbën ndjeshmëri ndaj mjedisit dhe i përgjigjet nevojave të përdoruesve me të ardhura të ulëta, grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara (përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit).

Rritja e qasjes së ndërmarrjeve të vogla industriale dhe ndërmarrjeve të tjera në shërbimet financiare, duke përfshirë kreditë e përballueshme dhe integrimin e tyre në zinxhirin e vlerave dhe në tregje.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe industrive rezervë për t'i bërë ato të qëndrueshme, me rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe adoptim më të gjerë të teknologjive të pastra dhe të shëndosha në aspektin mjedisor dhe të proceseve industriale, në pajtim me të gjitha vendet që veprojnë në përputhje me kapacitetet e tyre përkatëse.



## DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

### **Muaji Evropian i Sigurisë Kibernetike**

Tetori shënon Muajin Evropian të Sigurisë Kibernetike. AAB dhe Komiteti i Sigurisë së Informacionit i AAB-së organizuan një sërë seminaresh online, të cilët u zhvilluan gjatë gjithë muajit. Ngjarjet digjitale të këtij viti synuan të eksplorojnë tendencat dhe sfidat kibernetike për bankat dhe për të ndihmuar njerëzit të identifikojnë dhe të përgatiten për kërcënimet kibernetike.

#### **Credins Bank mbështeti:**

- Bashkinë Kamëz dhe Bashkinë MAT: Në dizajnin dhe prodhimin e broshurave informuese për paketën fiskale 2020 dhe në dhurimin e pajisjeve të ndryshme për zyrat e kësaj bashkie.
- Drejtorinë Arsimore Lushnjë: Dhuroi pajisje kompjuterike duke përmirësuar infrastrukturën e punës në dobi të mësuesve dhe qytetarëve.
- Kryqin e Kuq, Dega Elbasan dhe O.SH.K.SH: Dhuroi pajisje zyre për përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve.
- Mitropolinë e Shenjtë Korçë: Mbuloi shpenzimet për restaurimin e mjediseve të Mitropolisë.
- Postën Shqiptare, Filiali MAT: Dhuroi pajisje të ndryshme për zyrat e këtij institucioni.
- Dhuroi pajisje kompjuterike dhe sisteme teknologjike për përmirësimin e kushteve dhe shërbimit të ofruar për komunitetin në disa institucione si: Operatori i Kujdesit Shëndetësor, Spitali Rajonal Gjirokastër, Bashkia Kukës, Qendra Shëndetësore Vorë dhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

#### **Intesa Sanpaolo Bank Albania**

Gjatë vitit 2020, duke marrë parasysh rritjen e numrit të shërbimeve dhe transaksioneve në internet, banka ka organizuar disa fushata ndërgjegjësimi mbi sigurinë në internet, në mënyrë që të edukojë publikun për këto çështje të ndjeshme. Banka ka edhe një nënfaqe të dedikuar posaçërisht për Sigurinë Kibernetike.

#### **Raiffeisen Bank**

- Aplikon politika të kredidhënies dhe shërbimet/ produktet e ofruara në kanalet digjitale janë në përputhje me kërkesat ligjore/ rregullatorë në vend, dhe bazohen në praktikën më të mirë Evropiane të grupit Raiffeisen. Pagesat dhe transfertat në kanalet digjitale me kosto të ulura për klientët e Raiffeisen. Këto komisione janë 1/2 e komisioneve në degë, me qëllim që klientët të shmangin pritjet e panevojshme dhe të respektojnë distancën sociale.
- Për të 8-in vit me radhë mbështeti ICT Awards, veprimtarinë më të rëndësishme kushtuar teknologjisë dhe komunikimit, duke treguar mbështetje të plotë të promovimit të vlerave të ICT-së në trojet shqiptare dhe nxitjen e inovacionit. Ky konkurs mbarëkombëtar tashmë është kthyer në një institucion të vlerësimit të gjithë talentëve shqiptarë në sektorin e ICT-së, në promovimin dhe mbështetjen e tyre për të ecur në rrugën e inovacionit dhe kreativitetit. Kjo veprimtari u finalizua më datë 10 korrik me një mbrëmje gala, ku edhe u ndanë çmimet fituese në disa kategori.

#### **OTP Bank Albania**

Në kuadër të ndihmës që ofron për OJQ-të dhe shoqatat humanitare në të gjithë vendin, përgjatë muajit gusht mbështeti Kryqin e Kuq Vlorë dhe akordoi një fond për rinovimin e zyrave qendrore të këtij institucioni.

#### **Tirana Bank**

- Mbështeti Qendrën shëndetësore në Elbasan (kompjuterë dhe mjete pune).
- Pajisi me kompjuterë agjencinë rajonale të mjedisit në qytetin e Fierit.



## OBJEKTIVI #10 Zvogëlim i Pabarazive

Rreth **5.5** milionë lekë mbështetje në ndihmë të shtresave në nevojë /personave me aftësi të kufizuara dhe kundër diskriminimit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Përdorimi i teknologjive të reja, të tilla si shërbimet e pagesave nëpërmjet transfertave me celular për të krijuar modele operative dhe shpërndarëse më efikase dhe efektive për tregjet e reja, me qëllim zgjerimin e përfshirjes financiare.

Zgjerimi i përdorimit të teknologjive të reja, të tilla si të dhënat me kapacitet të madh dhe informatika në rene kompjuterike "cloud" për të fituar njohuri të reja që përmirësojnë analizat e riskut dhe të mundësive.

Sigurimi i mundësive të barabarta dhe reduktimi i pabarazive të rezultateve, duke përfshirë eliminimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjisllacionit, politikave dhe masave të duhura në këtë drejtim.

Përmirësimi i rregulloreve dhe monitorimi i tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe forcimi i zbatimit të këtyre rregulloreve. Lehtësimi i migrimit të drejtë, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmëria e njerëzve, përmes zbatimit të politikave të migracionit të planifikuara dhe të menaxhuara mirë.

### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

#### Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Marrëveshje me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me qëllim financimin e familjeve që përfitojnë nga programi qeveritar për hua të buta me interes të subvencionuar. ISBA është një nga tre bankat në Shqipëri që ofron këtë lloj kredie hipotekare me termat dhe kushtet më konkurruese.
- Mori pjesë në dy seminare të organizuara nga Zyra e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në kuadër të Fushatës së Kombeve të Bashkuara "Të Lirë dhe të Barabartë", të financuar nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe në bashkëpunim me ERA (organizata rajonale LGBTI). Këto veprimtari iu dedikuan informacionit në lidhje me komunitetin LGBTI në Shqipëri dhe përfshirjen e këtij komuniteti në mjedisin e punës.
- Gjatë nëntorit të vitit 2020, ISBA u ftua nga ADFR (Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar) për të marrë pjesë si anëtare në grupin e punës të ngritur në nivel kombëtar, në mënyrë që të hartonte një fushatë ndërgjegjësimi shumëplanëshe për promovimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e stafit të Bankës janë 3 persona me aftësi të kufizuara.

**ProCredit Bank**

Mbështet NVM-të në veprimtarinë e saj. Hapi teknologjik është shpesh më i madh dhe rrit produktivitetin e punës së një fuqie punëtore më të madhe, pasi NVM-të priren të punësojnë shumicën dërrmuese të njerëzve, ndërsa në të njëjtën kohë llogariten për një pjesë të madhe të vlerës së shtuar. Në nivel lokal, efikasiteti i arritur sjell çmime më të ulëta për konsumatorin fundor. Në nivel ndërkombëtar, këto përpjekje rrisin konkurrencën ndërkombëtare të firmave novatore në vend, si dhe nxisin eksportet, zëvendësojnë importet dhe ulin çekuilibrimet strukturore në tregti. Duke qenë se Bankat ProCredit zakonisht operojnë në ekonomi të vogla të hapura, kjo përkthehet në varësi të jashtme më të vogël, qëndrueshmëri më të madhe ekonomike dhe rritje më të fortë të brendshme, dhe në gjenerimin e punësimit zyrtar për popullatën lokale.

**PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE****Alpha Bank Albania**

- Për të dytin vit radhazi, banka ishte një nga mbështetëset e programit “Tungjatjeta Jetë” të World Vision Albania, një program social që ofron shërbime të specializuara për fëmijë me aftësi ndryshe.
- Tetori është muaji i ndërgjegjësimit për sindromën Down. Banka bashkëpunoi me dy OJQ të ndryshme që operojnë në Shqipëri dhe mbështetën këtë kauzë, si dhe krijoi dhe prezantoi në kanalet e saj të mediave sociale një video nën moton “Unë kam një kromozom shtesë, por jam si ju”. Gjithashtu, Banka dhuroi fonde për të mundësuar terapi të hershme falas, të cilat janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me sindromën Down, si dhe tableta për terapi në internet që është terapia më e re e prezantuar në Shqipëri për shkak të pandemisë COVID-19. Mbështetja konsistoi edhe në dhurimin e produkteve për të rritur për mbrojtjen ndaj COVID-19 për të gjitha ata që ndjekin terapitë në ambientet e organizatave.

Me rastin e 21 marsit: “Dita Botërore e Sindromës Down”, **Raiffeisen Bank** mbështeti për të shtatin vit radhazi fondacionin “Down Syndrome Albania” në fushatën “Çorapet shumëngjyrëshe” (Lots of socks). Kjo fushatë vjen në ndihmë fëmijëve me sindromën Down, për të përfutur shërbime më të mira terapeutike.



## OBJEKTIVI #11 Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme

Hua për shtëpi eficiente (përdorimi më i mirë i energjisë, izolimi, ngrohja, kursimi i energjisë elektrike, etj.). Mbi **416** hua të reja të dhëna në vlerën mbi **6.2** miliardë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020: **27.5** miliardë lekë.

Hua për sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimeve **3** hua të reja të dhëna në 2020 në vlerën **11** milionë lekë.

Investim në projekte në mbrojtje dhe ruajtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në vlerë **17** milionë lekë.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Vendosja e bashkëpunimit mes palëve të interesit në qytet për të analizuar dhe rritur rezistencën e sistemeve të ndërvarura, si për shembull infrastruktura e transportit dhe shërbimet komunale, të cilat përbëjnë themelet e rezistencës së aseteve individuale.

Edukimi i pronarëve të shtëpive dhe bizneseve për materialet dhe teknikat e ndërtimit rezistente ndaj motit, dhe ofrimi i stimuljeve për zbatimin e tyre.

Shpërndarja e informacionit për rrezikun, me qëllim informimin lidhur me legjislacionin e qeverisë mbi zonimin e tokës dhe kodet e ndërtimit në praktikë.

Përforcimi i përpjekjeve për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës.

Sigurimi i qasjes universale në hapësira të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

## DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

**Banka Credins** ka mbjellë pemë në Tiranë, Krujë dhe Fier, si dhe ka iniciuar një projekt për ndërtim të stacioneve të biçikletave, ku përgjatë vitit 2020 janë finalizuar 9 stacione në Tiranë.

**Banka Kombëtare Tregtare** ofron Kredinë e Gjelbër, një produkt që mund t'i ofrohet të gjithë individëve që duan të investojnë në banesat e tyre, nëpërmjet projekteve që sigurojnë kursim energjie dhe reduktim të emetimeve të CO2. Kjo kredi mund të ofrohet si kredi me ose pa kolateral.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** që nga viti 2015 ka iniciuar një projekt për zbatimin e zgjidhjes së printimit të centralizuar, i cili ul përdorimin e letres, CO2 dhe eliminon bojën e printerit (të zëvendësuar me makineritë qendrore të cilat janë multifunksionale). Zyrat kryesore janë pajisur me ndriçim LED për të siguruar një depërtim të mirë të dritës natyrore për kursimin e energjisë.

### ProCredit Bank

Si institucion financiar, mbron mjedisin kryesisht për sa i përket konsumit të energjisë, ujit, letres dhe materialeve të tjera, transportit dhe pajisjeve, dhe kushteve të ndërtimit. Për sa i përket aktiviteteve të saj, banka tërthorazi ndikon edhe në mjedis përmes shërbimeve që u ofron klientëve të saj (përfshirë shërbimet bankare dhe financimin) dhe përmes shërbimeve dhe produkteve që konsumon nga furnizuesit e jashtëm. Banka ka përpunuar dhe zbatuar një Politikë Mjedisit dhe synon të promovojë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm ndaj mjedisit. Qëllimi është përmirësimi i performancës së jashtme mjedisore të bankës përmes krijimit dhe ofrimit të shërbimeve të veçanta të kreditit ("Eko kredi") si për biznesin ashtu edhe për klientët privatë për investime në eficientë të energjisë (EE), energjitë të rinovueshme (RE) dhe investime miqësore ndaj mjedisit. Duke bërë investime eko, klientët reduktojnë faturat e shërbimeve, rrisin komoditetin e shtëpive të tyre dhe përmirësojnë kushtet e jetesës.

**Union Bank** ofron kredinë "Kursim+" dhe mundëson financimin e investimeve në banesa që sigurojnë kursim në faturat e energjisë, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e komoditetit dhe praktikitetit të banesës.

Në datat 20-22 shkurt 2020, Union Bank ishte pjesëmarrëse në panairin "Ndërtim, Arkitekturë dhe Planifikim Urban 2020" i cili u organizua në ambientet e Expo City ku u prezantua kredia "Kursim+", e cila i dedikohet të gjithë klientëve individë që dëshirojnë të kryejnë investime në banesat e tyre, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe kursimin e energjisë. Në stendën e Union Bank, vizitorët patën mundësi të njihen nga afër me avantazhet e investimeve me eficientë energjie dhe me kushtet e vendosura nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për përfitim të grantit deri në 20% të kredisë.





## PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

**Alpha Bank Albania** mbështeti krijimin e tregut të artizanëve i vendosur pranë liqenit në qytetin e Pogradecit.

### **Raiffeisen Bank**

- Ndër projektet më të rëndësishme të mbështetura, të cilat synojnë një jetë sa më cilësore për komunitetin, ka qenë krijimi i këndeve të lojërave në disa qytete të ndryshme në të gjithë vendin, si p.sh. Pogradec, Krujë, Memaliaj dhe Delvinë.
- Falë mbështetjes së Raiffeisen, është bërë e mundur rikonstrukcioni i Muzeut Historik në qytetin e Lushnjës dhe dekorimi i qytetit të Korçës me rastin e festave të fundvitit. Një tjetër projekt ishte dhe “Babagyshi sekret”, i cili bëri shumë fëmijë të lumtur me rastin e festave të fundvitit.

### **Tirana Bank**

- Për Bashkinë Pogradec, në ndihmë të shitësve sezonalë, u ofruan kioska dhe kosha mbeturinash për shëtitoren.
- Mbështeti Bashkinë Dropull për përmirësimin e rrugës, për shkak të dëmtimit të shkaktuar nga reshjet e shiut.
- Ndërtoi një kënd lojërash për fëmijët, në një nga zonat periferike të kryeqytetit. Parku prej 520 metra katrorë ndodhet në Sauk dhe është ndërtuar sipas një projekti të përbashkët me Bashkinë e Tiranës.

**Union Bank** gjatë sezonit turistik të verës vendosi në dispozicion të pushuesve 100 çadra në një nga plazhet publike të qytetit të Vlorës. Çadrat ishin të disponueshme për t'u përdorur nga çdo turist apo qytetar pa pagesë. Në fund të sezonit turistik, kjo sasi çadrash iu dhurua Bashkisë së Vlorës, për t'u përdorur gjatë sezoneve turistike të ardhshme.



## OBJEKTIVI #12 Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm

**3** hua me këtë destinacion në vlerën mbi **50** milionë lekë dhe shuma e paguar **127** milionë lekë.

Rreth **36** milionë lekë kontribut në menaxhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efikas të burimeve natyrore.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Zhvillimi i modeleve të reja për vendosjen e çmimeve për nxitjen e një jete më të qëndrueshme.

Arritja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shfrytëzimit eficient të burimeve natyrore.

Ulja në mënyrë të konsiderueshme e prodhimit të mbetjeve nëpërmjet parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.

Nxitja e shoqërive, veçanërisht shoqërive të mëdha dhe ndërkombëtare, për miratimin e praktikave të qëndrueshme dhe integrimin e informacionit që lidhet me qëndrueshmërinë në ciklin e tyre të raportimit.

Sigurimi që njerëzit të kenë në çdo vend informacionin dhe sensibilizimin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës, në harmoni me natyrën.

### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

**American Bank of Investments** ka investuar për zgjidhjet e menaxhimit të printimeve në zyrat qendrore dhe rrjetin e degëve të Bankës, për uljen e volumit të përdorimit të letrës dhe asgjësimin e saj nëpërmjet shoqërive të riciklimit.

**Banka OTP Albania**, gjatë këtij viti ka ricikluar 2700 kg pajisje elektronike të vjetërsuara dhe 2200 kg letër.



### Tirana Bank

38 135 kg letër është destinuar për asgjësim, nga të cilat 34 049 kg mund të riprodhohet dhe në këtë mënyrë janë kursyer:

- a) 102 011 kg pemë
- b) 1 079 357 litra ujë
- c) 222 283 kwh energji
- d) 5925 kg CO2 (gjatë prodhimit)

\*Përlllogaritjet janë bërë bazuar në IPR

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Investoi në ristrukturimin dhe riorganizimin e ambienteve të punës në zyrat qendrore dhe degën kryesore ku respektohet energjia e gjelbër, interneti, ndriçimi i drejtuar dhe standardet e OH&S (devijimi, dalja e emergjencës, etj.)

Letër e certifikuar: eko-qëndrueshme (në kg)	17 128
Mbetje speciale jo të rrezikshme: letër dhe karton (në kg)	1170
Mbetje speciale jo të rrezikshme: toner, shirita dhe film (në kg)	60
Mbetje speciale të rrezikshme: të tjera (në kg)	680
Mbetje speciale jo të rrezikshme: të tjera (në kg)	7500
Mbetje speciale jo të rrezikshme: pajisje zyre (në kg)	10



## OBJEKTIVI #13 Veprim për Klimën

Rreth **7** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Investime në – dhe/ose rritje të financimit për zbutjen e rrezikut klimatik, qëndrueshmërinë klimatike dhe adaptimin klimatik, duke përfshirë hua shtesë dhe instrumente të kapitalit.

Marrja e masave për matjen, zvogëlimin dhe raportimin e ekspozimit klimatik dhe progresit të veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike, me vijimin e rritjes së nivelit të transparencës dhe përputhshmërisë së raportimit në të gjithë sektorin e industrisë.

Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit adaptues ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet. Integrimi i masave ndaj ndryshimeve klimatike në politika, strategji dhe planifikime kombëtare. Përmirësimi i edukimit, rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, adaptimi, zvogëlimi i ndikimit dhe paralajmërimi i hershëm ndaj zbutjes së ndryshimeve klimatike.

### DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

**Alpha Bank Albania** iu bashkua nismës globale “Ora e Tokës” e organizuar nga WWF, duke fikur të gjitha dritat në zyrat e saj qendrore dhe duke ftuar edhe stafin dhe klientët të bënin të njëjtin veprim në datë 28 mars, ora 20:30-21:30.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** ka miratuar një rregullore ku nuk lejohen financimet e aktivitetit që prodhojnë karbon, veçanërisht nxjerrjen e karbonit.

**ProCredit Bank** zbaton konceptin e Sistemit të Administrimit të Mjedisit në Shqipëri. Gjatë vitit 2020, të gjithë treguesit e konsumit janë në rënie, ku rënia më e madhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 janë emetimet e karbonit, pasuar nga konsumi i ujit, energjia dhe konsumi i letrës.

Indikatorët	Rënia krahasuar me vitin 2019
Energjia në total (kWh)	-24%
Energjia elektrike (kWh)	-9%
Konsumi i ujit në total (m3)	-39%
Letër e printuar në total (kg)	-8%
Energji për flotën e automjeteve për nevoja vetjake (kWh)	-17%
Emetime nga fluturimet në total ( kgCO2eq)	-84%
Emetimet në total ( kgCO2eq)	-63%

**ProCredit Bank** vazhdoi të mbështesë investimet me Kredinë Eko. Portofoli i Huasë Eko të bankës përbën 19% të totalit të portofolit të kredisë. Banka do të vazhdojë të përqendrohet në rritjen e ndërgjegjësimit për masat e efijencës së energjisë, duke sjellë në jetë përpjekje të forta për t'u shpjeguar klientëve përfitimet nga investimi në teknologji miqësore ndaj mjedisit.

**Raiffeisen Bank** prej më shumë se 12 vitesh promovon dhe mbështet pastrimin e zonave bregdetare si edhe fushatat e ndërgjegjësimit lidhur me mbajtjen pastër të mjedisit. Në bashkëpunim me forumin e “Mendimit të Lirë” u mundësuan 4 aksione për pastrimin e disa vijave bregdetare në vend, ku nuk mungoi edhe kontributi vullnetar i stafit të bankës.



## OBJEKTIVI #14 Jeta nën ujë

Hua për peshkimin (rritje e peshkut, mjete peshkimi, etj.):

**32** hua të reja të dhëna në vlerën mbi **135** milionë lekë.

Shuma e pa paguar në fund të vitit 2020: **215** milionë lekë.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Minimizimi dhe trajtimi i ndikimeve të acidifikimit të oqeanëve, duke përfshirë bashkëpunimin shkencor të të gjitha niveleve.

Rregullimi në mënyrë efektive i mbledhjes së prodhimit dhe ndalimi i mbipeshkimit, peshkimit të paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar dhe praktikave shkatërruese të tij. Zbatimi i planeve të menaxhimit të bazuara në rezultate shkencore, në mënyrë që të ruhen rezervat e peshkut për një kohë sa më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivelet që mund të prodhohet maksimumi i qëndrueshëm, siç përcaktohet nga karakteristikat e tyre biologjike.

Ruajtja e të paktën 10 përqind të zonave bregdetare dhe detare, në përputhje me ligjet kombëtare dhe ndër-kombëtare, të bazuara në informacionin më të mirë shkencor të disponueshëm.



## OBJEKTIVI #15 Jeta në Stere

Financim për mbjellje: **23** hua të reja të dhëna në 2020 në vlerën **234** milionë lekë. Shuma e papaguar në fund të vitit 2020: **390** milionë lekë.

Rreth **5.6** milionë lekë mbështetje për institucionet dhe komunitetin.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Përdorimi i metodave novatore financiare për të mbledhur fonde, me qëllim ruajtjen e pyjeve dhe ekosistemeve.

Promovimi i ndarjes sa më të drejtë të përfitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike, dhe promovimi i aksesit së duhur në këto burime, në përputhje me standardet e vendosura dhe të miratuara në nivel ndërkombëtar.

Mobilizimi i rezervave nga të gjitha burimet dhe nivelet, për të financuar administrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe ofrimin e stimujve të mjaftueshëm për vendet në zhvillim, për përparimin e një administrimi të tillë, duke përfshirë ruajtjen dhe pyllëzimin.

### DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

#### Credins Bank

- Në bashkëpunim me organizatën “Njerëz dhe Ide” dhe Bashkinë Tiranë, mbështeti projektin “Ballkone të Gjellbra”, një nismë mjaft e bukur për të rritur ndërtimin e hapësirave të gjelbra në ballkonet e kryeqytetit dhe për ti kthyer ballkonet në një hapësirë të këndshme për çdo familje, si dhe një kënd relaksues pune.
- Duke ju bashkuar nismës së Bashkisë Krujë, stafi i bankës, në bashkëpunim me Bashkinë e Krujës, mbollën mjaft pemë, duke përmirësuar dhe gjelbëruar mjedisin në këtë qytet.

**Raiffeisen Bank** ka financuar projekte për mbjellje të pemëve në qytetet Tiranë, Durrës, Delvinë dhe Këlcyrë. Falë bashkëpunimit të vazhdueshëm me Bashkinë e Tiranës u mbështet nisma për pyllëzimin e Tiranës, duke bërë të mundur mbjelljen e 250 pemëve në aksin rrugor Kombinat - Vaqar si dhe shtimin e gjelbërimit në disa qytete të ndryshme në të gjithë vendin, si Këlcyrë, Krujë dhe Durrës.



# OBJEKTIVI #16 Paqe dhe Drejtësi Institucione të Forta

## MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Bashkëpunimi me investitorë të tjerë institucionalë për çështje të reja apo të diskutueshme, për promovimin e biznesit të përgjegjshëm në zonat me rrezik të lartë, duke siguruar që shoqëritë investuese të shohin një korrelacion të qartë mes biznesit të përgjegjshëm, disponueshmërisë, dhe çmimit të kapitalit.

Promovimi i shtetit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar akses të barabartë në drejtësi për të gjithë.

Ulja thelbësore e korrupsionit dhe ryshfetit në të gjitha format e tyre. Sigurimi i vendimmarrjes së përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfundimtare në të gjitha nivelet. Përhapja dhe fuqizimi i pjesëmarrjes së vendeve në zhvillim në institucionet e qeverisjes globale.

## DREJTIMI PËRMES SHEMBUJVE

**Intesa Sanpaolo Bank Albania** zbaton së brendshmi disa politika që favorizojnë gjithëpërfshirjen dhe diversitetin, të cilat bazohen në mbrojtjen e parimeve themelore të të drejtave të njeriut, siç specifikohet më poshtë:

- Kodi i Brendshëm i Sjelljes
- Parimet e të Drejtave të Njeriut
- Parimet e Diversitetit dhe Përfshirjes
- Rregullat e diversitetit për orientimin seksual dhe identitetin

**16** PEACE, JUSTICE  
AND STRONG  
INSTITUTIONS





## OBJEKTIVI #17 Partneritet për Objektivat

Rreth **755** mijë lekë mbështetje ndaj institucioneve dhe komunitetit.

### MUNDËSITË PËR VLERA TË PËRBASHKËTA

Forcimi i lidhjes mes krijimit të vlerave të korporatave dhe shoqërisë, dhe harmonizimi i strategjisë së krijimit të vlerës së organizatës me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pjesëmarrja në iniciativa me shumë palë interesi që përkrahin zhvillimin e qëndrueshëm.

Zhvillimi i një sërë objektivash të industrisë së shërbimeve financiare të përafuara me OZhQ dhe harmonizimi i strategjisë së korporatave me ato objektiva, me qëllim optimizimin e kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm.

Bashkëpunimi me shoqëritë e tjera të shërbimeve financiare dhe palët e interesit për të ofruar perspektiva të industrisë për qeveritë, politikëbërësit, ligjvënësit dhe rregullatorët, mbi ndikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të kuadrit ligjor, rregullator dhe tatimor, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim.

### DREJTIMI PËRMES SHEMAJVE

#### Alpha Bank Albania

- Mbështeti Ambasadën Greke në Shqipëri në përgatitjet për organizimin e një koncerti online për festimin e 200 vjetorit të Revolucionit Grek të vitit 1821.
- Mbështeti Agna Leadership Academy në organizimin e eventit “Rruga Drejt Suksesit”. Një event unik virtual dhe plot ndërveprim, të ardhurat prej të cilit dhurohen për bamirësi.

#### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Është banka e parë në vend që ka promovuar së brendshmi OZhQ-të. Angazhimi i bankës ndaj temave të CSR ka një ndikim të konsiderueshëm në vend, me pjesëmarrjen e stafit më të lartë drejtues në disa komitete me rëndësi thelbësore për Shqipërinë (p.sh., në Komitetin Kombëtar për Rindërtimin e Shqipërisë, krijuar menjëherë pas tërmetit të 26 nëntorit 2019). Banka ka bashkëpunuar me organizatën e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, ICC Albania dhe aktorë të tjerë në lidhje me OZhQ-të. Banka, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, mori pjesë në veprimtarinë “OZhQ-të dhe sektori privat”, organizuar nga ICC në 14 tetor 2020, për festimin e 5 vjetorit të OZhQ në Shqipëri.

**Banka OTP Albania** mbështeti aktivitetin “Pranvera e Frankofonisë”, një aktivitet, i cili organizohet çdo vit nga Ambasada Franceze në Shqipëri.

Rreth **55** milionë lekë mbështetje për veprimtari në fushën e artit, kulturës dhe sportit.

**Alpha Bank Albania** mundësoi organizimin e ekspozitës “Gjurmë çastesh – Duke ëndërruar vazhdimësinë” në bashkëpunim me Gallery70. Ekspozita u vizitua nga shumë artistë dhe qytetarë nën masa të rrepta kundër Covid-19.

#### **Banka Amerikane e Investimeve**

- Për të katërtin vit radhazi, mbështeti Klubin Sportiv “Studenti”.
- Financoi publikimin e enciklopedisë “Shqipëria në Art” të autorit Ferid Hurdhi, e cila sjell një histori të shkurtër të artit shqiptar.
- Mbështeti koncertin “Thesaret e Shpirtit” në Teatrin Andon Zako Çajupi në Korçë.
- Mbështeti Teatrin e Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor si sponsor i përgjithshëm.
- Mbështeti për të dytin vit radhazi serinë e Podcasteve “Shqiptarët e mrekullueshëm”, një bashkëpunim i ABI Bank dhe Rudina Xhunga, që sjell histori suksesi të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit.

#### **Credins Bank**

- Mbështeti veprimtarinë “Sofra Tiranase 2020”, me artistët më të njohur të muzikës popullore shqiptare.
- Mbështeti ADISA-n në Gjirokastër, në organizimin e veprimtarisë për fëmijë me aftësi ndryshe.
- Mbështeti Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Maqedoni me blerjen e 4 botimeve të “Testimonial from the Presidential Cabinet”.
- Mbështeti Shoqatën Kulturore VIZart në realizimin e ekspozitës “VIZart”, e cila sjell së bashku punët e 50 mjeshtrave shqiptarë që i përkasin brezave të ndryshëm që nga Kodra, Jukniu, Kilica, Dhrami, Shoshi, Lulani, Keraj, Madhi, Mele, Leka, e shumë artistë të njohur, duke përfshirë dhe organizatorin e kësaj ekspozite Helidon Haliti.
- Mbështeti botimin e librit: “Ky është Driteroi im”. Një botim me kujtime mbresëlënëse nga miqtë dhe kolegët që kanë bashkëpunuar ndër vite me shkrimtarin e madh.
- Mbështeti organizimin e “Festës së Gjysheve”. Një aktivitet kulturor për të ruajtur dhe trashëguar vlerat e kulinarisë dhe trashëgimisë, organizuar në Përmet, ku për 2 ditë pati një larmi performuesish dhe aktivitetesh.
- Mbështeti organizimin e Ditës Ndërkombëtare të Shefave të Kuzhinës. Një aktivitet i organizuar me pjesëmarrje të shefave më të njohur të kuzhinës dhe shumë fëmijëve, duke u fokusuar në rolin që ka ushqimi në shëndetin e fëmijëve.
- Mbështeti Federatën Shqiptare të Aeronautikës për organizimin e edicionit të 21-të “Albania Open 2020”, në Vlorë, i cili u mbyll me një ceremoni ndarje çmimesh për fituesit.
- Mbështeti Shoqatën Kulturore “Kulturë pa Kufi - Egnatia”: Në organizimin e veprimtarisë kulturore-artistike “Kastriot Tusha & Ardian Trebicka - Tirana Parfum -100 vjet Live Show TV”, e cila solli për publikun interpretimin e këngëve të muzikës shqiptare të viteve 50-60.
- Mbështeti koncertin “Break the Darkness” të artistit Eugent Bushpepa.
- Mbështeti prodhimin e botimit “Shejzat”.
- Mbështeti ekspozitën me pikturat e artistit të mirënjohur dhe talentuar shqiptar z. Abaz Hado, duke e

kthyer degën qendrore në një galeri arti dhe duke i dhënë një mbështetje artistit dhe artistëve shqiptarë në këto kohë.


## **Raiffeisen Bank**

- Mbështeti Teatrin Kombëtar në kalendarin artistik të vitit; shfaqjet online të projektit “The show must go on”, si dhe produksionin artistik kushtuar të rinjve: “TK RIN ART ON”.
- Mbështeti kalendarin artistik të Teatrit të Kukullave, duke bërë të mundur argëtimin dhe edukimin e brezave të rinj nëpërmjet artit.
- Sponsor gjeneral i edicionit të parë të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar me metrazh të shkurtër “Dardan Fest 2020”. Urbanizimi, civilizimi dhe zhvillimi ishin tematikat kryesore të këtij edicioni, i cili u mbajt nga data 27-30 tetor në kryeqytet.
- Për të mos ndalur pasionin, talentin dhe buzëqeshjen e fëmijëve, mbështeti aktivitetin e organizuar nga qendra gjenerata e re “Fëmijët ndryshojnë botën”. Kjo veprimtari ngjiti vogëlushët në skenën e amfiteatrit të Tiranës, me debutimet e tyre të ndryshme artistike në këngë e valle.
- Veprimtaritë artistike: koncertin recital “Tre musketierët”; “Pianodrom 2020”; edicionin e 9-të “Jazz fest 2020” si dhe ZA Fest.
- Mbështeti Komitetin Olimpik Kombëtar shqiptar për fazën përgatitore të sportistëve për pjesëmarrjen në Lojërat Olimpike në Tokyo 2020.
- Mbështeti sportisten Luiza Gega për fazën përgatitore për lojërat Olimpike Tokyo 2020.
- Shkolla 9-vjeçare “Sabaudin Gabrani” në kryeqytet ka tashmë dy terrene të reja sportive falë mbështetjes së Raiffeisen.
- Mundësoi rikonstruksionin e terreneve sportive në zonën e lungomares në qytetin e Vlorës si dhe ndërtimin e pjesshëm të qendrës sportive “Tirana United” në kryeqytet.

## **Union Bank**

- Edhe gjatë vitit 2020, ka vijuar mbështetjen për Kombëtaren Shqiptare të Futbollit, si vijim i marrëveshjes me Federatën Shqiptare të Futbollit të rinovuar për periudhën 2018-2020. Edhe pse viti 2020 ishte i vështirë për sa i përket aktiviteteve sportive, Union Bank qëndroi besnike ndaj ekipit kuqezri nën moton #Gjithmonë me Kombëtaren, duke e mbështetur atë në të gjitha sfidat.
- Gjatë muajit janar, organizoi një ceremoni për dorëzimin e trofeut “Futbollisti më i mirë gjatë Eliminatorëve Euro 2020” për lojtarin e përfaqësueses shqiptare Odise Roshi, i cili u zgjodh nga votimi i vetë publikut të faqes zyrtare të Union Bank në Facebook. Aktiviteti u organizua në ambientet e Muzeut të Kombëtares Shqiptare të Futbollit pranë Air Albania Stadium.





## RAIFFEISEN BANK, PËRGJEGJËSIA E KORPORATËS

Qëndrojmë të përkushtuar në mbështetjen e  
Zhvillimit të Qëndrueshëm në shoqëri, duke  
vërtetuar që veprimet në mënyrë etike!



90 projekte  
të mbështetura  
në komunitet  
gjatë 2020.



74% e projekteve në  
përfutje me parimet e  
Objektivave të Qëndrueshme të Qëndrueshme [SDG] të  
Kombeve të Bashkuara  
për një botë më të mirë.

